2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI : BLERJE MATORIALE HIDRAULIKE PER MIREMBAJTJEN E UJIT TE PIJSHEM DHE TE UJRAVE TE ZEZA.

Tuba polietileni të destinuar për përdorim njerëzor për ujë të pijshëm HDPE100.

Tubat duhet të përgatiten nga material i pastër/ i papërpunuar PE (Poli-Etilen) dhe me klasifikim MRS. Materiali të jetë jo-toksik dhe inert në kontakt me ujin. Jetëgjatësia e tubit duhet të jetë mbi 50 vjet. Të jetë fleksibël dhe rezistent ndaj dridhjeve dhe goditjeve sizmike. Rrezja e përkuljes të jetë e barabartë me 20d. Tubat duhet të jenë rezistent ndaj rrezeve UV dhe rezistent në rangun e temperaturave -30° deri +60° C, rezistencë e madhe edhe ndaj gërryerjes. Tubat për dërgimin e ujit për konsum njerëzor duhet të jenë të zinj ose blu. Tubat duhet të kenë certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW). Tubat HDPE duhet të vërtetojnë rezistencën e tyre ndaj presioneve të larta dhe deformimit mekanik ndaj forcave statike e dinamike tubat duhet të jenë konform me standardin EN 12201 ose ekuivalent , për të vërtetuar këtë ofertuesi duhet të paraqesi në ofertën e tij certifikatën përkatëse.

Tuba të brinjëzuar

Tub polietileni me ngjyrë e zezë dhe me peshë të lehtë. Produkti duhet të jetë i përbërë me material të papërpunuar dhe me rezistencë të lartë goditje me densitet 900 kg/m³ dhe rang temperaturë -40° deri +40°C. Tubat të jenë të prodhuar në përputhshmëri me standartet SRPS-EN13476 dhe EN1440 ose ekuivalent. Tubat të kenë koeficient fërkimi 0.25 mm. dhe sipas klasit SN8. Jetëgjatësia e tubave 100 vjet. Tubat të jenë rezistent ndaj gërryerjes, cilësi të mira mekanike, fleksibilitet të mirë dhe pa përmbajtje metalesh të rënda.

Fasheta Riparimi Inoksi

Fashetat duhet të jenë fleksibël dhe të kenë disa shtresa inoksi të veshura me gome EPDM rezistente në temperaturë të lartë dhe të jenë të prodhura e të përshtatshme posaçërisht për linjat e furnizimit të ujit të pijshëm. Të jenë të pajisura me dado, bulona dhe rrota, me të njëjtin material si më sipër, të cilat duhet të jenë të veshura me material SS304 për të penguar ndryshkjen. Veshja e jashtme dhe pjesët bashkuese duhet të jenë gjithashtu SS304, ndërsa pjesa e brendshme duhet të jetë EPDM. Baza mbajtëse duhet të jetë material SS304 si dhe tapa mbyllëse plastike. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm për linjat e ujësjellësit.

Dimensionet e Fashetave Riparimi Inoksi të jenë sipas preventivit.

L=200mm

Të dhënat teknike për fashetën 108-118mm: presioni 10-16bar

Të dhënat teknike për fashetën 132-142mm: presioni 10-16bar

Të dhënat teknike per fashetën 145-155 mm:presioni10-16bar
Të dhënat teknike per fashetën 218-228mm: presioni 10-16bar
L=500mm
Të dhënat teknike per fashetën 88-108mm: presioni 10-16bar
Të dhënat teknike per fashetën 159-170 mm: presioni 10-16bar
Të dhënat teknike per fashetën 505-525mm: presioni 6-10 bar

TEE PE PN10-25

Produkti duhet të jetë i përbërë prej polietilieni.Të jetë i prodhuar me injektim.
Produkti duhet te jetë konform me standartet UNI EN 1555-3; UNI EN 12201-3; ISO 4437-3; ISO 4427-3; UNI EN ISO 15494.

Reduksion PE PN10-25

Reduksion me material PE Reduksioni duhet të gjejë përdorim në tubacionet e ujesjellsave. Reduksionet duhet te shfaqin rezistence te larte dhe duhet durojne presione deri ne 16 bar. Produktet duhet të kenë certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW).

Adaptor PN 10-25

Adaptori duhet të gjejë përdorim në tubacionet e ujesjellsave, të ketë certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW).Materiali të jetë prej polipropileni me rezistencë ndaj rrezeve UV.Temperatura maksimale e punës 45° C.Të jetë i përshtatshëm për ujin e pijshëm dhe të përputhet me standartet ISO,UNI,DIN.Filetimet të përputhen me standartet UNI-ISO 7/1, DIN 2999, BS 21, EN 10226-1.

Fllanxhë Adaptor

Fllanxha Adaptor duhet të jenë të përbëra prej materiali çeliku dhe me veshje plastike. Certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW).

Tapa PE PN 16

Tapa me material PE, presion maksimal 16 bar,temperatura maksimale e punës 45° C. Të jetë i përshtatshëm për ujin e pijshëm dhe të përputhet me standartet ISO,UNI,DIN. Filetimet të përputhen me standartet UNI-ISO 7/1, DIN 2999, BS 21, EN 10226-1. Certifikatë të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW). Përmasat e tapave PE duhet të jenë sipas preventivit.

Bashkuese PE PN 10-16

Bashkuese me material PE, presion maksimal 16 bar,temperatura maksimale e punës 45° C. Të jetë i përshtatshëm për ujin e pijshëm dhe të përputhet me standartet ISO,UNI,DIN. Filetimet të përputhen me standartet UNI-ISO 7/1, DIN 2999, BS 21, EN 10226-1. Certifikatë

aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW). Përmasat e bashkueseve PE duhet të jenë sipas preventivit.

Brryl PE

Brrylat me material PE, presion maksimal 16 bar, temperatura maksimale e punës 45° C. Të jetë i përshtatshëm për ujin e pijshëm dhe të përputhet me standartet ISO, UNI, DIN. Filetimet të përputhen me standartet UNI-ISO 7/1, DIN 2999, BS 21, EN 10226-1. Certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW). Përmasat e brrylave PE duhet të jenë sipas preventivit.

Saracineskë me levë

Saracineskat duhet të jenë të përbëra prej materiali bronxi dhe rezistente ndaj presioneve minimalisht 16 bar. Është e rëndësishme që materiali që është i përbërë saracineska të mos ndikojë në ndryshime cilësore të ujit si arome apo shije. Saraçineskat duhet të jenë të tipit me levë. Përmasat për saraçineskat duhet të jenë sipas preventivit.

Saracineske G me Fllanxhe Ø65-Ø250 PN 16

Saracineskat duhet të jenë të tipit me gjuhez në formë pyke. Gjuheza ka formën e një pllake fleksibel e cila mundeson rrjedhjen apo bllokimin e ujit neper tubacione. Zhvendosja e gjuhezes bëhet me anë të një boshti i cili është i pajisur me fileto me seksion trapezoidal. Komandimi boshtit bëhet manualisht me dorë nepermjet volanit ose me mekanizëm në rastin e saracineskave të cilat janë me dimension më të madh se Ø 300. Trupi i saracineskes duhet të jetë i përbërë prej materiali gize ose celiku ku të shfaqin rezistencë ndaj temperaturave dhe presionit 16bar. Në trupin e saracineskave duhet të ketë të inkuorporuar nga të dyja anët fllanxha të cilat konstruktivisht duhet të jenë sipas standardit EN 1092-2 ose ekuivalent. Saraçineskat me fllanxhë duhet të jenë të përshtatshme për linjat e ujit sipas direktivës europiane 2014/68/EU të paisjeve nën presion. Ndërsa materiali i veshjes së tyre të jetë për përdorim të ujit të pijshëm si edhe mos të ndikojë në cilësinë e ujit. Për ta vërtetuar këtë ofertuesi në ofertën e tij duhet të paraqesë certifikatë.

Standarti i dizenjimit të saracineskes duhet të jetë DIN3352 ose ekuivalente, ndërsa veshja e jashtme duhet të jetë me material rezinë sipas standardit EN14901 ose ekuivalent.

Përmasat e Saracineskave me Fllanxhë PN 16 duhet të jenë sipas preventivit.

Ajrues Çeliku

Produkti duhet të jetë i përbërë prej material gize dhe i pajisur me fllanxhë sipas standardit EN 1092-2 ose ekuivalentin e saj. Ajruesi duhet të jetë i përshtatshëm për presione 10-16 bar. Veshja e jashtme duhet të jetë me material rezinë Epoxy sipas standardit EN14901 ose ekuivalente. Temperatura e fluidit 0-70°C. Izolimi me material EDPM. Standarti i ajëruesit EN 1074-4 ose ekuivalente ku të ketë të shënuar dhe në trup.

Rakorderite Zingato

Produktet duhet te perbehen nga material metalik zingato .Presioni qe duhet te durojne te jete 16 bar.Ne trupin e tyre rakorderite xingato duhet te kene te kene te markuar marken CE ose ekuivalente. Permasat duhet te jene sipas preventivit.

Dado, Bulona, Prizhoniera

Dado, bulona dhe prizhoniera sipas përmasave në preventiv. Të jenë material çelik i temperuar. Hapi i filetosh të jetë 1.5 mm. Prizhonierat të jenë me gjatësi 1 m.

Guarnicion i armuar

Guarnicionet duhet te jete te pershtatshme te perdoren per tubat e ujesjelles kanalizime. Guarnicionet duhet te kene aftesi solide dhe elastike qe te perballojne sforcimet mekanike qe lindin si pasoje e procesit te shtrengimit gjate instalimit ne fllanxhat e tubacioneve apo gjate periudhes se te operimit.

Konstruksioni i tyre duhet te jete i perberje prej materialesh gomine EPDM elastike dhe fiber qelqi amianti per celik te bute. Permasat sipas percaktimeve te zerave ne preventive.

Paste hidraulike, Ngjitës tubi, Elektroda, Silkone etj

Paste filetash hidraulike të jetë e përshtatshme për punime hidraulike.Të gjitha aksesoret ndihmes per hidraulikun duhet të permbushin kërkesat maksimale të cilësës dhe të kenë ndikime minimale negative në mjedis sipas standarteve të kerkuara. Gjithashtu këto materiale ndihmëse duhet te jenë të përshtatshëm për perdorim në tuba ku rrjedhë uji i konsumit të perdishem dhe nuk kanë efekte anësore në ruajtjen dhe garantimin e cilësisë se materialit të instaluar.

Tuba dhe rakorderi PPR

Ato duhet te jene te perbera prej materiali cilesor polipropileni si dhe me perberje polimeri (kopolimer). Duhet te kene aftesi te mira te ruatjes se formes se tyre ndaj faktoreve te ndryshme atmosferik.Te perdoren per presione 16bar ose 1.6 MPa. Duhet te jene te pershtatshem per tu perdorur ne linjat e ujit te pijshem dhe te jene te certikuuar me certificate aprovimi te leshuar nga Institucion Nderkombetar ose Kombetar per perdorimin ne linjat e ujit te pijshem (p.sh DVGW). Ato duhet te jene rezistent ndaj ujit te fresket, ujit te kripur, kimikateve dhe lengjeve shume gerryes.

Kolektor Uji

Kolektor (shperndares) me 12 dalje ½ dhe me furnizim kryesor Ø 63, perdoret gjeresisht per instalimet me tub PE per furnizmin e familjeve me uje, matriali te jete rezistente ndaj gryerja e agjenteve atmosferik. Produkti duhet te perbehen nga material metalik xingato .Presioni qe duhet te durojne te jete 16 bar. Ne trupin e tyre rakorderite xingato duhet te kene te kene te markuar marken CE ose ekuivalente.

Galixhant

Galixhantët bëjnë të mundur hapjen ose mbylljen e linjave në të cilat janë instaluar, duke u nisur nga kërkesa e grumbulluesit ku janë instaluar. Janë praktikë dhe shumë funksionale. Trupi i galixhantit duhet të jepe i perbere prej bronzi ose Inoks rezistent. Permasat duhet të jene sipas preventivit.

Bashkuese elektrofuzive

Bashkueset EF duhet të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm dhe duhet të kenë certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin me elektrofuzion. Të jenë të prodhuara me anë të derdhjes së plastikës. Tensioni i ngjitjes të jetë 30-40 V , bornat duhet të jenë me diameter 4mm. Presioni maksimal PN25 SDR7,4. Bashkueset EF duhet të jenë në përputhje me standartet UNI EN 12201-3; ISO 4437-3; UNI EN ISO 15494 UNI EN 1555-3; ISO 4427-3. Filetimet sipas standartit UNI EN 10226-1/ISO 7-1 ose ekuivalent.

Tapa elektrofuzive

Tapat EF duhet të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm dhe duhet të kenë certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin me elektrofuzion. Të jenë të prodhuara me anë të derdhjes së plastikës. Tensioni i ngjitjes të jetë 30-40 V , bornat duhet të jenë me diameter 4mm. Presioni maksimal PN25 SDR7,4. Tapat EF duhet të jenë në përputhje me standartet UNI EN 12201-3; ISO 4437-3; UNI EN ISO 15494 UNI EN 1555-3; ISO 4427-3. Filetimet sipas standartit UNI EN 10226-1/ISO 7-1 ose ekuivalent.

Brryla elektrofuzivë

Brrylat EF duhet të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm dhe duhet të kenë certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin me elektrofuzion. Të jenë të prodhuara me anë të derdhjes së plastikës. Tensioni i ngjitjes të jetë 30-40 V , bornat duhet të jenë me diameter 4mm. Presioni maksimal PN25 SDR7,4. Brrylat EF duhet të jenë në përputhje me standartet UNI EN 12201-3; ISO 4437-3; UNI EN ISO 15494 UNI EN 1555-3; ISO 4427-3. Filetimet sipas standartit UNI EN 10226-1/ISO 7-1 ose ekuivalent.

Tafa elektrofuzive

Tafat EF duhet të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm dhe duhet të kenë certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin me elektrofuzion. Të jenë të prodhuara me anë të derdhjes së plastikës. Tensioni i ngjitjes të jetë 30-40 V , bornat duhet të jenë me diameter 4mm. Presioni

maksimal PN25 SDR7,4. Tafat EF duhet të jenë në përputhje me standartet UNI EN 12201-3; ISO 4437-3; UNI EN ISO 15494 UNI EN 1555-3; ISO 4427-3. Filetimet sipas standartit UNI EN 10226-1/ISO 7-1 ose ekuivalent.

Fashetë elektrofuzive

Fashetat EF duhet të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm dhe duhet të kenë certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin me elektrofuzion. Të jenë të prodhuara me anë të derdhjes së plastikës. Tensioni i ngjitjes të jetë 30-40 V , bornat duhet të jenë me diameter 4mm. Presioni maksimal PN25 SDR7,4. Fashetat EF duhet të jenë në përputhje me standartet UNI EN 12201-3; ISO 4437-3; UNI EN ISO 15494 UNI EN 1555-3; ISO 4427-3. Filetimet sipas standartit UNI EN 10226-1/ISO 7-1 ose ekuivalent.

Reduktorë elektrofuzivë

Reduktorët EF duhet të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm dhe duhet të kenë certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin me elektrofuzion. Të jenë të prodhuara me anë të derdhjes së plastikës. Tensioni i ngjitjes të jetë 30-40 V , bornat duhet të jenë me diameter 4mm. Presioni maksimal PN25 SDR7,4. Reduktorët EF duhet të jenë në përputhje me standartet UNI EN 12201-3; ISO 4437-3; UNI EN ISO 15494 UNI EN 1555-3; ISO 4427-3. Filetimet sipas standartit UNI EN 10226-1/ISO 7-1 ose ekuivalent.

Adaptorë elektrofuzive

Adaptorët EF duhet të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm dhe duhet të kenë certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin me elektrofuzion. Të jenë të prodhuara me anë të derdhjes së plastikës. Tensioni i ngjitjes të jetë 30-40 V , bornat duhet të jenë me diameter 4mm. Presioni maksimal PN25 SDR7,4. Adaptorët EF duhet të jenë në përputhje me standartet UNI EN 12201-3; ISO 4437-3; UNI EN ISO 15494 UNI EN 1555-3; ISO 4427-3. Filetimet sipas standartit UNI EN 10226-1/ISO 7-1 ose ekuivalent.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Bashkangjitur dokumentave ne SPE

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa vlera e përlllogaritur e kontratës.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlerë jo më të vogël se 40% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte :

- *Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.”*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i Certifikuar sipas standartit ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë **ISO 9001- 2015** (e vlefshme) që lidhet me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucione zyrtare të akredituara për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jete e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër sipas akt-marreveshjes.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqese Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese katalogun/et të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi. Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen.

2.3.5. Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.

Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

-Emri, Adresa dhe website i kompanise prodhuese ose distributor i autorizuar, me produktet e të

Nr.	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa, web-siti	Emertimi i katalogut	Referenca ne katalogje/	Shënimet
				KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	

cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim.

- Emertimi i Katalogut të prodhuesit, Referenca në katalogje, kodi i produktit të plotësohet (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr,i faqes) duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ku AK mund të gjejë specifikimet teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK

2.3.6 Ofertuesi ne ditën dhe orën e hapjes se ofertave duhet te paraqesi mostrat prane Autoritetit Kontraktor. Produktet te cilat kerkohen te paraqiten mostrat jane te renditura si me poshtë sipas numrit rendor ne preventiv:

13; 14; 15; 34; 35; 36; 54; 55; 56; 68; 69; 70; 80; 81; 82; 86; 87; 88; 119; 120; 111; 112; 113; 136; 137; 138; 150; 151; 152; 153; 173; 174; 175; 189; 190; 191; 207; 208; 209; 217; 218; 265; 266; 267; 275; 278; 280; 281; 291; 292; 302; 303; 304; 321; 322; 323; 352; 353; 355; 369; 370; 384; 385; 386; 404; 405; 406; 433; 434; 443; 444; 445; 475; 476; 477; 481; 482; 500; 501; 502; 516; 517; 518; 533; 534; 535; 540; 550; 551; 552; 566; 567; 568; 582; 583; 584; 608; 609; 610; 612; 617.

2.3.7 Për të gjitha mallrat të cilat kanë kontakt me ujin e pijshëm (sipas specifikimeve teknike) operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë të aprovimit për përdorimin e ujit të pijshëm DVGW, ose ekuivalente (të vlefshme) të lëshuar nga një trup i certifikuar ndërkombëtar apo kombëtar i akredituar nga DPA.

2.3.8 Operatori Ekonomik per te kryer procesin e Furnizimit prane AK, duhet te disponojë në pronësi ose me qera:

- 1 (nje) mjet kamion me vinç,
- 1 (një) pirun teleskopik (MT)

Për mjetet në pronesi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b)çertifikata e kontrollit teknik; c) siguracioni i mjetit (i vlefshëm), ç) foto të mjetit.

Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) certifikaten e kontrollit teknik, c)siguracionin e mjetit (i vlefshëm), ç) fotot të mjetit. Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën, ne kopje origjinale ose te noterizuara, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

